REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:279776
Datë: 31.05.2021
Numri i dokumentit: 01832709

C.nr. 1469/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin Besnik Shala - në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. (B.) I., nga ....., rr. "....., i përfaqësuar nga av. M. K., nga ....., sipas autorizimit, kundër të paditurave Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga M. K. sipas autorizimit, dhe Kompania e Sigurimeve "....., me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga S. D., sipas autorizimit, me objekt kontesti kompensim dëmit sipas auto përgjegjësisë, me vlerë të kontestit 2.000 Euro, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqësve, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 11.05.2021, ndërsa me datë 31.05.2021, përpiloj këtë:

A K T GJ Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e të paditësit D. I., nga ....., ashtu që:

I. **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "....., me seli në Prishtinë, që paditësit D. I., nga ....., në emër të kompensimit të dëmit jo material të pësuar në aksidentin e datës 26.12.2018, t'ia paguaj shumat dhe atë për:

Demin jo material:

a) në emër te dhimbjeve fizike shumen prej 800.00 Euro

b) në emër të frikës shumën prej 500.00 Euro

Të gjitha këto si në pikën I të dispozitivi të këtij aktgjykimi me kamatë ligjore prej 8%, nga data **26.05.2021** (dita e përpilimit të këtij aktgjykimi), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

II. **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "....., me seli në Prishtinë, që paditësit D. I., nga ....., në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e datës 26.12.2018, t'ia paguaj shumat dhe atë për:

Demi material

a) në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 56.00 Euro

c) në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 56.00 Euro

2019:279777

Te gjitha këto si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi me kamat ligjore prej 8%, nga data 02.12.2019 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive e të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nen kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

III. **REFUZOHET PJESËRISHT SI E PABAZUAR**, kërkesë padia e paditësit D. I., përtej shumës së gjykuar, si në pikën I dhe II të dispozitivi të këtij aktgjykimi, për aksidentin e datës 26.12.2018, për shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material

a) në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumën prej 200.00 Euro

b) në emër të frikës shumën prej 500.00 Euro

Demi material

a) në emër të ë kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 84.00 Euro

b) në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 44.00 Euro

c) në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumen prej 140.00 Euro

IV. **REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR** kërkesëpadia e paditësit D. I., nga ....., me të cilën ka kërkuar të detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material të pësuar në aksidentin e datës 26.12.2018, t'ia paguaj shumat dhe atë për:

Dëmi jo material

a) në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumën prej 1.0000.00 Euro

b) në emër të frikës shumën prej 1.000.00 Euro

Demi material

d) në emër të ë kujdesit dhe ndihmës së huaj shumen prej 140.00 Euro

e) në emër të ushqimit të përforcuar shumen prej 100.00 Euro

f) në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumen prej 140.00 Euro

V. **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve ".....", me seli në Prishtinë, që paditësit D. I., nga ....., t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.250,00 euro, e të gjitha këto t'i përmbushë në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate fillimisht ka parashtruar padi, të kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, të njëjtën e ka zgjeruar edhe ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve ".....", me seli në Prishtinë, dhe precizuar me parashtresën e dt. 04.12.2020, me objekt kontesti kompensim dëmi me vlerë kontesti 2.380.00Euro.

I autorizuari i paditësit me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ne administrimin e provave në tersi janë vërtetuar pretendimet nga padia dhe baza e kërkese padisë. Është vërtetuar po ashtu legjitimiteti pasiv i të paditurve dhe obligimi i tyre

solidare ashtu që e paditura e parë pa marrë parasysh fajësinë është përgjegjëse sepse paditësi ka qenë udhëtar në automjet për të cilën përgjigjet e a paditura e parë, kurse e paditura e dytë mbi bazën e ekspertizave të komunikacionit mban përgjegjësi si shkaktare e aksidentit. Paditësi ka interes që për hire të sigurisë kërkese padinë të precizoj si obligim solidare, kërkese kjo të cilën ja mundëson ligji, kurse çështjet e fajësie do të jenë objekt shqyrtimi ne procedurën eventuale për rimbursim në mes të padituave. Lartësia e dëmit është ne harmoni me natyrën e të mirave të lënduara të konstatuar nga ekspertet ne procesverbalin e datës 23.11.2020, andaj gjykatës i propozojmë që kërkese padinë e paditësit ta aprovoj ne tërësi si të bazuar si ne precizimin e datës 04.12.2020, listën e shpenzimeve gjykatës do t'ia dorëzojmë ne formë të shkruar në afat prej 3 ditësh.

E autorizuara e të paditurës se parë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se edhe pas administrimit të shkresave të lëndës vërtetohet mungesa e legjitimitetit pasiv te të paditurës se parë ne këtë aksident dhe me qenë se edhe shkaktari i këtij aksidenti është palë ne procedurë nuk shohim të nevojshme që ky rast të lihet pezull edhe për proceduara të rimbursuimit pasi që të dy ekspertizat vërtetojnë se paditura e dytë është shkaktar i këtij aksidenti. Andaj kërkojmë nga gjykata që kërkese padia e paditësit të refuzohet në tersi ne raport me të paditurën e parë, sa i përket shpenzimeve të procedurës kërkoj shpenzimet për ekspertizën e punuar nga eksperti S. B..

I autorizuari i të paditurës se dytë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kontestojmë ne tërësi bazën e juridikë të padisë dhe kërkese padisë me arsyetimin se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike pasi që ekspertiza e ekspertit K. R. është ne tërësi ne kundërshtim me deklarimet në këtë seancë pasi që i njëjti për distancën prej 22.25m konstatoj se automjeti ka humbur 68km/h kurse momenti kur e ka parë rrezikun ka qenë larg 45m, pra kjo ekspertize fare nuk është e kuptueshme andaj për të paditurën e dytë është mbetur pa u sqaruar baza lidhur me përgjegjësinë është fakt se paditësi është palë e tretë dhe duhet të mbrohet juridikisht pasi që të njëjtit fare nuk i intereson se kush është përgjegjës për aksidentit por sipas nenit 178 të LMD-së mund ti drejtohet secilit pjesëmarrëse, ne rastin konkret i propozojmë gjykatës qe te obligojë të paditurën e parë për kompensimin e dëmit dhe ne rast se e paditura e parë pretendon se përgjegjës për shkaktimin e aksidentit është e paditura e dytë mund te ushtroj padi në gjykatën ekonomike, andaj për të paditurën e dytë është tërësisht kontestuese.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjen faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë reparti i Emergjencës i datës 09.01.2019, raporti nga konsulta e datës 26.12.2018, raporti i aksidentit me numër të rastit DR3004-960-18 i datës 26.12.2018, raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë reparti i Emergjencës i datës 26.12.2018 me numër protokolli 28443, procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit me numër DR3004-960-18 i datës 17.01.2019, konstatimet e eksperteve nga lemia e ortopedisë dhe e psikiatrisë, ekspertiza nga lemia e komunikacionit e përpiluar me datë 02.12.2020 nga Ing.S. B., ekspertiza e komunikacionit e përpiluar me datë 10.03.2021 nga Ing. K. R..

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me provat e administruara siç janë raporti i aksidentit me numër të rastit DR3004-960-18 i datës 26.12.2018, procesverbali mbi vend shikimin e aksidentit me numër DR3004-960-18 i datës 17.01.2019, për gjykatën u bë jokontestues fakti se me dt. 26.12.2018, në aksin rrugor ....., pikërisht në fshatin ....., Komuna e ....., kishte ndodhur aksident i komunikacionit rrugor në të cilin ishin të përfshira tri automjete, automjeti (A) i tipit "....., me ngjyrë të hirtë, me targa të regjistrimit ....., (i siguruar tek KS ".....") të cilin e drejtonte L. Z.-J., automjeti (B) i tipit "....." me ngjyrë të kaltër, me targa regjistrimi ....., dhe automjeti (C), i tipit ".....", me ngjyrë të kaltër, me targa regjistrimit ....., ku paditësit në cilësinë e pasagjerit në automjetin (C) i ishin shkaktuar lëndime trupore.

Meqenëse për palën e paditur-të padituren e parë ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë gjykata sipas propozimit të palës paditëse ka nxjerrë si provë ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti i komunikacionit rrugor Ing.i dipl. S. B., me dt. 02.12.2020, në të cilën është konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur për shkak se ngasësja e automjetit A, të markës ".....", me ngjyrë të hirit metalike e cila gjatë ngasjes se automjetit nuk ka qenë e kujdesshme sa duhet duke kaluar me automjet prej shiritit të djathtë në shiritin e majtë në kahun e kundërt të lëvizjes, dhe si pasojë e mos kujdesit të duhur të ngasëses së automjetit A, vije deri te kalimi me automjet prej shiritit të djathtë në shiritin e majtë në kahun e kundërt të lëvizjes duke e goditur automjetin B dhe pastaj me automjetin C, ku edhe shkaktohen lëndime trupore dhe dëme materiale, duke u bazuar në këtë ekspertizë gjykata në seancën e dt. 08.02.2021, e ka lejuar zgjerimin e padisë në kuptimin subjektiv që si palë e paditur të përfshihet KS ".....", ku ishte i siguruar automjeti A.

Pasi që për palën e paditur-të padituren e dytë ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe ekspertiza e lartcekur, gjykata sipas propozimit të autorizuarit te të padituresë se dytë ka nxjerrë si provë ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti i komunikacionit M.Sc.Ing.Dip. K. R., me dt. 10.03.2021, në të cilën është konstatuar se derti te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të ngasës se automjetit (A) të tipit ".....",sepse e ngasë automjetin e saj me një mënyrë jo të rregullt duke mos iu jap përparësi dhe duke mos respektuar të drejtën e lëvizjes së automjeteve në shiritin e tyre qarkullues, e cila në momentin kritik duke kaluar në mënyrë të menjëhershme në shiritin e kundërt qarkullues ia ndërprenë rrugën automjetit (B) të tipit ".....", dhe automjetit (C) të tipit "....." (të cilët ishte duke lëvizur në shiritin e vet qarkullues, përball saj nga drejtimi i kundërt) e humb kontrollin mbi automjet duke kaluar papritmas në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe e pjesën e parë të automjetit e godet automjetin (B) të tipit ".....", në pjesën e majtë anash, në atë moment në të njëjtin drejtim dhe në të njëjtin shirit me automjetin (B) ishte duke lëvizur edhe automjeti (C) i tipit ".....", i cili me të vërejtur rrezikun në rrugë kishte reaguar me frenim të vrullshëm për rreth 22.5 m, por për shkak të daljes se menjëhershme në shiritin e tij qarkullues të automjetit (A) të tipit "....." nuk kishte arritur që të ndalet por me pjesën e parë të automjetit e kishte goditur automjetin (A) në pjesën e

majtë anash (tek goma e pasme) e që kjo mënyrë jo e rregullt e ngasjes së ngasëses se automjetit (A) (ndërrim i menjëhershëm dhe i pasigurt i shiritit qarkullues, mosrespektim i rregullave të trafikut) ka rezultuar shkaktar i aksidentit, të cilave ekspertiza gjykata në tërësi ua fali besimin pasi që ishin punuar në mënyrë profesionale, ishin në përputhje me njëra tjetrën dhe me shkresat tjera të lëndës.

Sipas dispozitës së nenit 136.1 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159.1 parashihet se " në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësin në bazë të fajit ".

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga Dr. E. M. – ortoped, dhe Dr. M. H. – psikiatër, të cilët në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 23.11.2021, lidhur me natyrën e lëndimeve dhe pasojave për paditësin D. I., të shkaktuar në aksidentin e dt. 26.12.2018, në bazë të dokumentacionit të prezantuar në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit direkt të pacientit në gjykatë, kanë dhënë këtë mendim profesional:

Dr. E. M. – ortoped, ka deklaruar se paditësi ka pësuar këto lëndime ndrydhje te trupit dhe te qafës, gërvishtje te dy duarve dhe gjurit te majtë. Natyra e lëndimit është e lehtë i aksidenturari ka pas dhimbje te intensitetit tejet te lartë ne kohe zgjatje prej gjysme ore, i aksidentuari ka përjetuar dhimbje te intensitetit te larte ne kohe zgjatje prej 2 orëve, i aksidentuari ka përjetuar dhimbje te intensitetit te mesëm ne kohe zgjatje prej 7 ditësh, i aksidentuari ka dhimbje te intensitetit te ulët ende te cilat i menaxhon me barëra, i aksidentuari ka pas nevojë për ndihmën e personit të tretë ne kohë zgjatje prej 7 ditësh për arsye se ka pasur ndrydhje te trupit dhe qafës, te dy duarve dhe gjurit të majtë, i aksidentuari ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar te pasur me proteina dhe vitamina ne kohë zgjatje prej 7 ditësh, i aksidentuari ka pasur nevojë për terapi fizikale ne kohë zgjatje prej 10 ditësh, i aksidentuari ska shëmtim, i aksidentuari nuk ka zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor.

Dr. M. H. -psikiatër, ka deklaruar se paditësi- i ka përjetuar frike sekondarë te intensitetit te larte ne kohë zgjatje prej 3 orëve duke llogaritur kohen nga momenti i aksidentit dërgimi i tij ne QKMF ne Kline dhe pastaj ne emergjencën e spitalit te përgjithshëm në Peje ku janë bere ekzaminimet dhe rehabilitimi mjekësor kjo periudhë është përcjella me mundim, te rrahura te shpejtuara të zemrës, frymëmarrje të vështirësuar, dridhje te muskujve dhe ankesave tjera trupore. Frike sekondare me intensitet te mesëm ka pasur ne periudhën kohore gjerë ne 4 jave e qe është manifestuar me një çrregullim afektiv si pasojë e aksidentit si: indisponim pengesa te here pas hershme ne gjumë, rikujtim i ngjarjes traumatike, shkalle me te ulët te tolerancës frustrative dhe ankesa te tjera trupore. Frike sekondare me intensitet të ulët ka pasur ne periudhën kohore gjerë në 3 muaj e që është manifestuar gjatë kur ka dal ne komunikacion apo ngjarjen qe ja rikujtojnë aksidentin

Gjykata në tersi i ka falur besimin konstatimeve të eksperteve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës dhe gjithashtu palët ndërgjyqësve pas deklarimit të eksperteve mjekësor nuk kanë pasur vërejtje në mendimin e tyre, për çka gjykata i fali besimin e plotë mendimit të eksperteve.

Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasoj e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishte pësuar paditësja në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës se përjetuar, sipas gjetjeve të bëra nga ekspertët mjekësor, moshën e paditëses ne kohën e aksidentit, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësen, e duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh më qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 183 të LMD-së përcaktohet se "me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe qëllimin shoqëror". Pra, nga kjo dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballje te tejkalimit të pasojave që në këtë rast paditësja ka pasur në aksidentin e datës 26.12.2018.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi janë të drejta për paditësin.

Sipas vlerësimit të Gjykatës kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material dhe atë: për ndihmën dhe kujdesin e personit tjetër dhe për ushqimin e përforcuar, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: " Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ". Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, edhe përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke u nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave

në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi D. I., ka pasur nevojë për ndihmë të huaj në kohëzgjatje prej 7 ditësh, dhe ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 7 ditësh, ku të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihëm dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin jo material, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt.

Për pjesën e refuzuar të kërkesë padisë, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ndërlidhet me dëmin material si ndihmë dhe kujdes të huaj ne shumen prej 84 euro, ushqim i përforcuar ne shumen prej 44 euro, pasi që gjykata vlerëson se paditësi nuk e ka argumentuar me asnjë provë kërkesën e tij për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që sipas dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-së, secila palë ndërgjyqëse, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Ndërsa sa i përket kompensimit për terapi fizikale pala nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme në bazë të cilës do të vërtetonte pretendimet e veta që të i kompensohet kjo kategori e dëmit material, andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar tërësisht kërkesëpadinë e paditësit në raport me të padituren e parë BKS me seli në Prishtinë, pasi që në bazë të dy ekspertizave të komunikacionit u vërtetua se shkaktar i aksidentit ishte automjeti (A) i tipit ".....", me ngjyrë të hirit metalike, me targa të regjistrimit ....., i cili ishte i siguruar tek e paditura e dytë KS ".....", me seli në Prishtinë.

Gjykata e refuzoi propozimin e të autorizuarit te të padituresë se dytë për nxjerrjen e provës me ekspertizë të re të komunikacionit, pasi që të dy ekspertizat e komunikacionit të nxjerra në këtë kontest nga dy ekspert të komunikacionit të ndryshëm, ishin në përputhje me njëra tjetrën, e po ashtu me dispozitën e nenit 369.2, të LPK-së, parashihet se "në qoftë se të dhënat e ekspertëve në konstatimin e ekspertëve dallohen esencialisht, apo nëse konstatimi i tyre është i paqartë, jo i plotë apo kontradiktor me vet veten apo me rrethanat e shqyrtuara, e këto të meta nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertëve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njëjtë apo me ekspertë të tjerë".

Gjykata vendimin për kamatën e ka mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, për dëmin jo material konsideron se nga momenti i përpilimit të aktgjykimit (datë 26.05.2021) pala

e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për llojin dhe vëllimin e dëmit të shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket dëmit material gjykata konsideron se nga momenti i parashtrimit të padisë në gjykatë (data 26.11.2019) pala e paditur bie në vonesë dhe është e detyruar, që përveç dëmit të paguaj edhe kamatë, se nga ky moment kupton për dëmin e shkaktuar, andaj edhe është vendosur si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë vetëm sa i përket të paditurës se dytë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 1.250,00 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, taksën për padi shumën prej 31 euro, përpilimin e parashtresës për precizimin e padisë shumën prej 104 euro, për ekspertiza mjekësore të ekspertëve mjekësor shumën prej 200 euro, për gjashtë seanca të mbajtura për secilën nga 135.20 x 6=811.20 euro).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:279776, C.nr.1469/19, 31.05.2021

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,
në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes, në Gjykatën
e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.